



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

PLANI DHE PROGRAMI VJETOR I PUNËS 2019

(Miratuar nga Kolegjiumi i gjyqtarëve të Gjykatës, datë 27.12.2018)

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

Përmbajtja:

Fjala e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj	2
Organogrami i Gjykatës Themelore në Ferizaj	3
Organogrami i Gjykatës - Dega në Shtërpçë.....	4
Organogrami i Gjykatës – Dega në Kaçanik.....	5
Përmbledhje	6

Plani i Punës për vitin 2019

I. Organizimi i punës në Gjykatën Themelore të Ferizaj	7
II. Funkcionet gjyqësore dhe Udhëheqja e Departamenteve	7
III. Përbërja e Kolegjeve, ndarja e lëndëve dhe procedura paraprake.....	10
IV. Degët e Gjykatës.....	11
V. Ndihma Juridike Ndërkombëtare.....	12
VI. Caktimi i shqyrtimeve gjyqësore dhe publikimi i orarit të mbajtjes së tyre	12
VII. Mbledhjet e kolegjiut të gjithë gjyqtarëve, departamenteve dhe divizioneve.	12
VIII. Orari i punës Respektimi i Kodit të Mirësjelljes.....	13
IX. Komisioni Administrativ i Gjykatës Themelore.....	13
X. Implementimi i programit TIK/SMIL	13
XI. Transparenca dhe Llogaridhënia.....	14

Programi për zgjidhjen efikase të lëndëve për vitin 2019

I. Departamentet e gjykatës Prioritetet dhe rekomandimet për vitin 2019	15
II. Komunikimi me Institucione veprimtaria e të cilave ka ndikim në veprimtarinë e Gjykatës	21
Përfundimi.....	22

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

FJALA E KRYETARIT

Procesi i drejtësi bërjes është një proces jetik për funksionimin e gjithmbarshëm dhe normal të një shoqërie bazuar në parimin e sundimit të ligjit, prandaj përfundimi i proceseve gjyqësore në kohë sa më të justifikueshme kohore dhe pa vonesa, rritja e transparencës dhe llogaridhënies, ngritja e cilësisë së vendimeve gjyqësore, janë komponentë thelbësore dhe objektiva për vitin 2019, në mënyrë që të arrihen standardet më të avancuara të drejtësisë të cilat aplikohen në vendet e zhvilluara të BE-së të cilën të drejtë duhet ta gëzojnë qytetaret tonë.

Progresi i arritur këto vite pas reformës në sistemin e drejtësisë në vitin 2013, evidentohet në përmirësimin e shërbimeve të gjykatës, modernizimin e vazhdueshëm si në aspektin e infrastrukturës, ashtu edhe ndihmën e ofruar për publikun me ndihmën e teknologjisë së informacionit të avancuar, digjitalizimin e sistemit për menaxhimin e lëndëve si dhe ofrimin e informatave të ndryshme duke përfshirë edhe numrin e madh të publikimit të vendimeve gjyqësore përmes portalit gjyqësor, të cilat konsideroj se kanë lehtësuar qasjen në drejtësi dhe rritjen e besueshmërisë.

Qëllimi i këtij dokumenti është të trajtoj në mënyrë specifike çështjen e efikasitetit të gjykatës në kuptimin e veprimeve të cilat ndërliken me zgjidhjen e numrit të lëndëve.

Është e nevojshme që t'i konsolidojmë praktikatat që janë treguar të suksesshme dhe produktive, t'i përmirësojmë praktikatat të cilat nuk kanë dhënë rezultate, të ndërmerren veprime riparuese në funksion të tejkalimit të vështirësive të identifikuara. Rrjedhimisht, nevojitet që të ketë një organizim më të avancuar dhe një menaxhim më efektiv në zgjidhjen më të shpejt të çështjeve. Përfundimisht, jemi të përkushtuar që procesin e drejtësisë ta bëjmë më të shpejtë, më cilësor dhe më të besueshëm.

Bashkim Hyseni

Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i vendeve të Punës në Gjykatën Themelore në Ferizaj

Gjykata Themelore në Ferizaj			
Zyra e Kryetarit	Nr i pozitive	Zyra e Administratorit	Nr i pozitive
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional	10	Administratori i Gjykatës	1
Zyrtar Certifikues	1	Zyrtari i Personelit 2	1
Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave	1	Zyrtar për Përkthime	2
Asistent Administrativ 3	1	Zyrtar Ligjor 1	14
Zyrtar i Prokurimit 2	1	Asistent Administrativ 3	10
Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave	1		
Zyrtar për Shpenzime	1		
Arkëtar 3	1		
TOTAL	17	Total	28

Sektori për Menaxhimin e Lendëve	Nr i pozitive	Sektori i Logjistikës	Nr i pozitive
Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Lëndëve	1	Udhëheqës i Sektorit për Mbështetje dhe Logjistikë	1
Referent i Lartë	10	Zyrtar për Logjistikë 1	1
Referent 3	5	Zyrtar i Teknologjisë Informative	1
Zyrtar për Statistika	1	Operatori Teknik	1
Zyrtar për Arkiv 2	1	Receptionist	1
Zyrtar për arkiv 3	1	Total	5
		Dorëzues	4
		Shofer	2
		Shtëpiak	1
		Roje sigurimi	10
		Mirëmbajtës Higjiene	4
TOTAL	19		21

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i vendeve të Punës në Degën në Shtërpçë

Dega në Shtërpçë			
Zyra e Gjyqtarit Mbikëqyrës	Nr i pozitave	Zyra e Ndihmës Administratorit	Nr i pozitave
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional	2	Ndihmës Administrator i Gjykatës	1
Asistent Administrativ 3	1	Referent i Larte	2
TOTAL	3	Referent 3	2
		Zyrtar për Përkthime	1
Dorëzues	2	Arkëtar 3	1
Shofer	1	Zyrtar për arkiv 3	2
Shtëpiak	1	Zyrtar i Teknologjisë Informative	3
Roje Sigurimi	5	Asistent Administrativ 3	1
Mirëmbajtës Higjiene	1	Receptionist	1
TOTAL	10	TOTAL	13

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i vendeve të Punës në Degën në Kaçanik

Dega në Kaçanik			
Zyra e Gjyqtarit Mbikëqyrës	Nr i pozitave	Zyra e Ndhmës Administratorit	Nr i pozitave
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional	1	Ndhmës Administrator i Gjykatës	1
Asistent Administrativ 3	1	Referent i Larte	3
TOTAL	2	Referent 3	2
		Zyrtar për Përkthime	1
Dorëzues	2	Arkëtar 3	1
Shofer	1	Zyrtar për arkiv 3	1
Shtëpiak	1	Zyrtar i Teknologjisë Informative	1
Roje Sigurimi	5	Asistent Administrativ 3	4
Mirëmbajtës Higjiene	2	Receptionist	1
TOTAL	11	TOTAL	15

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

PËRMBLEDHJE

Me qëllim të funksionimit më të mirë dhe efikas të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe bazuar në nenin 12 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr/ 03/L-199) dhe nenit 24 të Ligjit mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovë, Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, pas marrjes së propozimit të Kolegjiumit të kësaj gjykate, përcakton Planin e Punës dhe Programin për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve, të gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore në Ferizaj për vitin 2019.

Ky plan i punës dhe programi për zgjidhjen efikase të lëndëve për vitin 2019, është strukturuar në atë mënyrë që të avancoj aktivitetet dhe rezultatet me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të punës së Gjykatës Themelore në Ferizajt, si në aspektin e organizimit profesional ashtu edhe në atë administrativo teknik, realizimi i të cilave do të bëhet përmes aktiviteteve të arritshme brenda periudhës një vjeçare.

Plani dhe programi vjetor i Gjykatës për vitin 2019 përcakton: organizimin e punës në Gjykatën Themelore në Ferizaj, organizimin e punës së administratës gjyqësore, funksionet gjyqësore, emërimin e udhëheqësve të Departamenteve dhe Përgjegjësit e Divizioneve, përbërjen e Kolegjeve, ndarjen e lëndëve gjyqësore, procedurën paraprake, orarin e punës, kodin e mirësjelljes, caktimin e shqyrtimeve gjyqësore dhe publikimi i orarit të mbajtjes së tyre, publikimi i aktgjykimeve të formës së prerë, planifikimin e mbledhjeve të kolegjiut të gjyqtarëve të gjykatës, implementimin e programit Sistemit elektronik për Menaxhimin e Lëndëve - SMIL, prioritetet e departamenteve të gjykatës dhe rekomandimet për departamentet përkatëse etj. Qëllimi i këtij dokumenti është të trajtoj në mënyrë specifike çështjen e efikasitetit të gjykatës në kuptimin e veprimeve të cilat ndërlidhen me zgjidhjen e numrit të lëndëve.

Gjykimi i çështjeve gjyqësore brenda afateve ligjore edhe për këtë vit do të jetë një prej prioritetëve kryesorë të gjykatës, ndarja në punë të lëndëve për gjyqtarë do të bëhet në mënyrë transparente dhe të barabartë për secilin gjyqtar, ndërsa shorti për ndarjen e lëndëve do të vazhdoj të funksionoj në mënyrë elektronike.

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

Shtyrjet e seancave gjyqësore duhet minimizuar maksimalisht, sidomos në Divizionin Civil, gjyqtarëve të ngarkuar me këto çështje, u kërkohet të tregojnë më shumë kujdes me rastin e përgatitjes së tyre për trajtimin e një rasti.

I. Organizimi i punës në Gjykatën Themelor të Ferizaj

Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore në Ferizaj, udhëheqë kryetari i gjykatës. Në mungesë të kryetarit me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës udhëheq nënkryetari i gjykatës Sahit Krasniqi, ndërsa për punën e degës së Gjykatës në Kaçanik – Zajrete Muhaxheri dhe Shtërpçë – Musa Konxheli, të cilët përgjegjës janë gjyqtarët mbikëqyrës.

Menaxhimi i punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve, do të bëhet nga Administratori i Gjykatës Themelore në Ferizaj Sejdi Sadiku, si dhe nga ndihmës administratorët e degëve të kësaj Gjykate, për degën në Kaçanik Xhevat Guri, ndërsa Degën në Shtërpçë Zorica Petkoviç.

II. Funksionet gjyqësore dhe udhëheqja e Departamenteve - Divizioneve

Për kryerjen e funksioneve gjyqësore të Gjykatës Themelore në Ferizaj, janë organizuar tre (3) Departamente:

- Departamenti për Krime të Rënda;
- Departamenti për të Mitur;
- Departamenti i Përgjithshëm, në kuadër të së cilit funksionojnë këto Divizione:
Divizioni Penal
Divizioni Civil dhe
Divizioni për Kundërvajtje

Me qëllim të organizimit më të mirë të punës si dhe zgjidhjen efikase të lëndëve, në kuadër të çdo Departamenti është i caktuar një gjyqtar si Udhëheqës i Departamentit. Ndërsa në krye të çdo divizioni, caktohet një gjyqtar Përgjegjës që do të organizoj dhe menaxhoi punën e atij divizioni.

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

Udhëheqësit e Departamenteve dhe përgjegjësit e Divizionit, do t'i raportojnë kryetarit të gjykatës për punën e Departamenteve - Divizionit, së paku njëherë në tre (3) muaj. Pjesë e raporteve të udhëheqësit të departamentit dhe përgjegjësit të divizionit, duhet të jenë edhe raportet e gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve.

Kryetari i Gjykatës, mund të kërkoj nga udhëheqësit e departamenteve ose gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve, që të paraqesin raporte mujore, ose raporte për ecurinë e lëndëve të veçanta.

Në Gjykatën Themelore në Ferizaj janë të sistemuar njëzetedy (22) të cilët do të punojnë në kuadër të Departamenteve dhe Divizioneve si vijon:

Në Departamentin për Krime të Rënda do të punojnë gjyqtarët:

- Bashkim Hyseni
- Sahit Krasniqi
- Ibrahim Idrizi
- Hysnije Gashi
- Musa Konxheli

Departamenti për Krime të Rënda

Në Departamentin për të Mitur caktohet gjyqtarja Kadrije Goga - Lubishtani, e cila njëkohësisht do të jetë edhe udhëheqëse e Departamentit. Sipas nevojës do të punojnë edhe gjyqtarët e tjerë nga Departamenti për Krime të Rënda.


Në Divizionin Civil do të punojnë këta gjyqtarë :



- Alban Beqiri
- Burim Emërllahu
- Misin Frangu
- Ardian Ajvazi
- Mirlinda Bytyqi Rexhepi
- Bekim Salihu
- Habib Zeqiri
- Burhan Berisha


Faton Ajvazi - caktohet të punoj në lëndët përmbaremore.

Në Divizionin Penal do të punojnë:



Në këtë divizion, gjithashtu do të jenë të angazhuar edhe gjyqtarët: Hysnije Gashi dhe Faton Ajvazi, ndërsa sipas nevojës do të punojnë edhe gjyqtarët e tjerë nga Departamenti për Krime të Rënda dhe Departamenti i Përgjithshëm.

Në Divizionin për Kundërvajtje do të punojnë:



Gjyqtarët gjatë vitit kalendarik 2019, mund të caktohen dhe ri-caktohen në departamente dhe divizione tjetër ndryshe nga sistematizimi i këtij plani, varësisht nga nevojat e gjykatës për të adresuar ngarkesën me lëndë, zvogëluar vonesat në kategoritë e caktuara të lëndëve dhe ngritur efikasitetin e gjykatës në përgjithësi.

Gjyqtarët që do të risistemohen nga një divizion në divizionin tjetër, do t'i mbajnë lëndët e divizionit të mëparshëm me të cilat kane qenë të ngarkuar, përveç nëse shprehimisht vendoset ndryshe.

Për udhëheqës të departamenteve dhe gjyqtar përgjegjës të divizioneve caktohen:

- Ibrahim Idrizi – Udhëheqës i Departamentit për Krime të Rënda;
- Kadrije Goga - Lubishtani - Udhëheqës e Departamenti për të Mitur;
- Alban Beqiri - Udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm dhe njëkohësisht gjyqtarë përgjegjës i Divizionit Civil;
- Adem Shabani - gjyqtar përgjegjës në Divizionit Penal;
- Bahri Salihu – gjyqtar përgjegjës në Divizionin për Kundërvajtje.

III. Përbërja e Kolegjeve, ndarja e lëndëve dhe procedura paraprake

Në Departamentin për Krime të Rënda, trupi gjykues përbëhet nga tre gjyqtar profesional.

Në Departamentin e Përgjithshëm, procedurat udhëhiqen nga gjyqtari i vetëm.

Në Departamentin për të Mitur trupi gjykues udhëhiqet konform Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Ndarja e lëndëve në punë e secilit gjyqtarë bëhet në mënyrë proporcionale. Lëndët ndahen mbi baza objektive, duke i dhënë çdo herë përparësi ndarjes elektronike, në pamundësi teknike të aplikimit të kësaj ndarje do të aplikohet metoda e shortit, ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren për Veprimtarinë e Gjykatave. Përfundim nga kjo rregull bëjnë lëndët e natyrës urgjente, të cilët caktohen konform dispozitave të Rregullores së lartcekur.

Nëse gjyqtarët të cilit i është caktuar lënda duhet përjashtuar nga arsyet e ndryshme, lënda duhet t'i caktohet trupit tjetër gjykues, arsyet për përjashtim nga kjo rregull duhet të regjistrohen në librin e regjistrimit.

Me këtë planë përcaktohet se të gjithë gjyqtarët në procedurën paraprake në Gjykatën Themelore në Ferizaj janë: Sahit Krasniqi, Ibrahim Idrizi, Musa Konxheli dhe Hysnije Gashi për Departamentin për Krime të Rënda, Hakile Ilazi, Ilir Bytyqi, Adem Shabani, Elmaz Zenuni, Fitore Daci për Divizionin Penal, ndërsa për Departamentin për të Mitur do të organizohet një kujdestari e përbashkët. Për degën në Kaçanik Zajrete Muhaxheri ndërsa degën në Shtërpcë Musa Konxheli. Gjyqtarët në procedurën paraprake duhet të jenë në gatishmëri të detyrës për një javë, mbi baza rotative dhe të barabarta. Në rast mungese të gjyqtarit kujdestar, zëvendësohet nga gjyqtari i cili është kujdestar sipas radhës së ardhshme vijuese.

IV. Degët e Gjykatës

Degët e Gjykatës Themelore në Ferizaj janë: Dega në Kaçanik dhe Shtërpcë, të cilat funksionin gjyqësor e kryejnë përmes Departamentit të Përgjithshëm, ndërsa secila degë e Gjykatës Themelore ka gjyqtarin mbikëqyrës i cili është përgjegjës për punën e degës.

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

Në degën e Gjykatës në Kaçanik do të punojnë gjyqtarët:

- Zajrete Muhaxheri – Gjyqtare Mbikëqyrëse – Gjyqtare në lëmine penal, njëkohësisht angazhohet për lëndët e Kundërvajtjeve
- Riza Livoreka – Gjyqtar në lëmin Civile
- Shabi Idrizi – Gjyqtar në lëmin Penale
- Burim Çaka - Gjyqtar në lëmin Penale.

Në Degën e Gjykatës në Shtërpcë do të punojnë gjyqtarët:

- Musa Konxheli – Gjyqtar mbikëqyrës - Gjyqtar në lëmin Panele
- Bersim Shaipi – Gjyqtar në lëmin Civile dhe lëmin për Kundërvajtje

Me lëndët në lëmin penale në Degën në Shtërpcë, gjithashtu do të jenë të angazhuar edhe gjyqtarët Mirlinda Bytyqi - Rexhepi dhe Habib Zeqiri.

V. Ndihma Juridike Ndërkombëtare

Kryetari i Gjykatës Themelore, vendos në çdo rast kur kërkohet ndihma juridike ndërkombëtare (*përveç kur për kërkesë duhet të vendos kolegji*) dhe për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja, si dhe në rastet e tjera kur me ligj është përcaktuar kompetenca e kryetarit të Gjykatës Themelore.

VI. Caktimi i shqyrtimeve gjyqësore dhe publikimi i orarit të mbajtjes së tyre

Shqyrtime gjyqësore caktohen nga gjyqtarët, përkatësisht kryetarët e trupave gjyqësore konform dispozitave të KPPRK-së dhe LPK-së. Orari i seancave gjyqësore regjistrohet në SMIL dhe publikohen në portalin gjyqësor.

VII. Mbledhjet e kolegjiut të gjithë gjyqtarëve, departamenteve dhe divizioneve

Së paku një (1) herë në muaj do të mbahet mbledhje e kolegjiut të gjithë gjyqtarëve, po ashtu së paku (1) herë në muaj, do të mbahet mbledhje e gjyqtarëve të departamenteve dhe të divizioneve përkatëse:

- a. Së paku dy (2) herë në muaj, do të mbahet mbledhje e gjyqtarëve të Departamentit për Krime të Rënda;
- b. Së paku dy (2) herë në muaj, do të mbahet mbledhje e gjyqtarëve të Divizionit Penal;
- c. Së paku dy (2) herë në muaj, do të mbahet mbledhje e gjyqtarëve të Divizionit Civile;
- d. Së paku një (1) herë në javë, do të mbahet mbledhje e gjyqtarëve të Divizionit për Kundërvajtje.

Sipas nevojës mbledhjet e kolegjiut mund të thirren në çdo kohë.

Pjesëmarrja në kolegjiute dhe mbledhjet e departamenteve dhe divizione, është e obligueshme.

VIII. Orari i Punës dhe Respektimi i Kodit të Mirësjelljes

Orari i punës në gjykatë fillon në ora 08:00 dhe zgjatë deri në ora 16:00, ndërsa pushimi ditor shfrytëzohet nga ora 12:00 deri në ora 13:00, në rast pamundësie të shfrytëzimit të pushimit brenda këtij orari, pushimi ditor mund të shfrytëzohet edhe jashtë këtij orari, por vetëm për të njëjtën ditë.

Të gjithë të punësuarit në Gjykatën Themelore në Ferizaj, janë të obliguar që gjatë orarit të punës në ushtrimin e pozitës zyrtare, të sillen në mënyrë korrekte, duke respektuar Kodin e Mirësjelljes për Personelin e Administratës Gjyqësore, njëkohësisht Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar.

IX. Komisioni Administrativ i Gjykatës Themelore

Komisioni Administrativ i gjykatës në përbërje nga kryesues - kryetari i Gjykatës Themelore dhe Gjyqtari Mbikëqyrës nga Dega në Kaçanik dhe Shtërpçë, ndërsa sekretar i komisionit menaxhuese administratori i gjykatës, takohet rregullisht dhe jo më pak se katër (4) herë gjatë vitit me ftesë nga Kryetari i Gjykatës, për të vlerësuar punën e gjykatës dhe ndërmarrjen e veprimeve riparuese në përputhje me rregullat dhe udhëzimet që janë të nevojshme për përmirësimin e veprimeve administrative të gjykatës.

X. Implementimi i programit TIK/SMIL

Gjykata Themelore në Ferizaj si gjykatë model, është në fazën e implementimit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL), i cili ka për qëllim rritjen e efikasitetit dhe transparencës së gjykatave në Republikën e Kosovës. Stafi i gjykatës, duke përfshirë edhe gjyqtarët janë trajnuar, andaj është e nevojshme që të gjithë të angazhohen dhe të tregojnë gatishmëri për implementimin e këtij programi, i cili do të transformojë regjistrat e lëndëve nga manuale në elektronike. Në vitin 2019 raportet e gjyqtarëve të lëmisë penale do të bëhen vetëm përmes sistemit SMIL, dhe do të bëhen përpjekje që kjo mënyrë të kalohet edhe në lëmine civile.

XI. Transparenca dhe llogaridhënia

Ueb portali i gjyqësorit edhe për vitin 2019 do të shërbej si urë lidhëse ndërmjet publikut dhe gjykatës, me qëllim të informimit të tyre rreth aktiviteteve, orarit të seancave gjyqësore, vendimeve, raporteve të përgjithshme statistikore për punën e gjykatës, raportet individuale të gjyqtarëve të cilat do të publikohen në baza mujore, për të cilat publiku njëkohësisht do të mund të informohet edhe përmes rrjetit social facebook.

Përveç këtyre shërbimeve të cilat ofrohen në portalin gjyqësor dhe rrjetet sociale, si shërbime shtesë të cilat dëshmojnë transparencën e gjyqësorit karshi publikut, në shërbim të tyre në hyrje të gjykatës është i vendosur edhe monitori i cili pasqyron kalendarin me orarin e të gjitha seancave

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

gjqësore si dhe tabelat e tjera orientuese, si në Gjykatën Themelore të Ferizajt ashtu edhe në degët e saj në Shtërpcë dhe Kaçanik.

Në anën tjetër të gjitha aktgjykimet e formës së prerë të çështjeve penale dhe civile, do të publikohen në ueb portalin gjyqësor të Republikës së Kosovës, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotfuqishme, si dhe konform vendimit të KGJK-së për përdorimin e nomenklaturës standarde për të gjitha dokumentet që ruhen dhe publikohen në ueb faqen zyrtare të gjyqësorit.

Programi për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve

I. Prioritetet e Departamenteve të Gjykatës dhe rekomandimet për vitin 2019

1.1. Departamenti për Krime të Rënda (DKR)

Prioritetet e DKR-së

Prioritet i DKR-së do të jetë kryerja e të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me veprat penale kundër detyrës zyrtare (me natyrë korrupsioni), krimit të organizuar dhe veprave penale të dhunshme dhe me pasoja të rënda. Për të njëjtat duhet të ndërmerren të gjitha masat e mundshme ligjore që të përfundohen sa më shpejt. Përfundimi i tyre ka një rëndësi të veçantë jo vetëm për gjykatën dhe sistemin drejtësisë, por për mbarë vendin, pasi do të ketë ndikim pozitiv në forcimin e sundimit të ligjit dhe ngritjen e sigurisë së përgjithshme në shoqëri. Lëndët e kthyer në rivendosje do të caktohen dhe përfundohen sipas afateve ligjore që përcaktohen për lëndët e tilla.

Konfiskimit dhe sequestrimit, do t'i kushtohet vëmendje e veçantë, në të gjitha rastet kur plotësohen kushtet ligjore të shqiptohen masat për konfiskimin e pasurisë së fituar me veprë penale, pasi që në këtë mënyrë do të dekurajohen kryesisht potencial dhe do të dërgohet mesazh i qartë se përfitimet e paligjshme nuk mund ti gëzon askush që i ka fituar në këtë mënyrë.

Gjatë këtij viti në DKR do të punojnë pesë (5) gjyqtar, si departament që trajton lëndët më serioze mund të konstatojmë se ka pasur një performancë të suksesshme, kur merret parasysh edhe numri i lëndëve pasive në këtë departament (*mbi 120 lëndë janë pasive*).

Rekomandimet për këtë vit:

- a) Të eliminohen shtyrjet e panevojshme;
- b) Të shkurtohet numri i seancave gjyqësore për ta përfunduar çështjen (përkundër faktit se natyra e çështjeve është më komplekse dhe serioze, numri i seancave të planifikuara duhet të jetë racional, i arsyeshëm dhe jo i tepruar);
- c) Të ketë një klasifikim të diferencuar të lëndëve si p.sh: komplekse, standarde dhe të thjeshta dhe varësisht nga ky klasifikim të planifikohet përfundimi i tyre;
- d) Të ndërtohen politika të cilat inkurajojnë marrëveshjet për pranimin e fajësisë të lidhura mes prokurorit dhe mbrojtësve të cilit përfaqësojnë të akuzuarit (pasi që kjo do të ishte mjaft

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

dobiprurëse si për efikasitetin për përfundimin më të shpejt të lëndëve po ashtu edhe për vetë palët dhe të dëmtuarit).

- e) Koordinim më i mirë i gjyqtarëve të këtij departamenti për formimin e kolegjeve në mënyrë që sa të jetë e mundur të minimizohet nevoja për gjyqtarë nga departamenti i përgjithshëm, (ngase kjo po reflektohet në vëllimin e punëve në divizionet nga vijnë këta gjyqtarë).

1.2. Departamenti për të Mitur

Prioritetet e DM - së

Prioritet i DM-së do të vazhdon të jetë përfundimi i të gjitha lëndëve të cilat bien në kompetencë të këtij departamenti, duhet të ndërmerren me kohë dhe pa vonesa të gjitha masat e mundshme ligjore që të përfundohen sa më shpejt.

Lëndët e kthyera në rivendosje do të caktohen dhe përfundohen sipas afateve ligjore që përcaktohen për lëndët e tilla.

Gjatë këtij viti në Departamentin për të Mitur do të një (1) gjyqtar, në këtë departament përveç gjyqtarës së ngarkuar me çështjet penale për të mitur, nga 1 janari i vitit 2019, do të angazhohen sipas nevojës edhe gjyqtarë tjerë nga DKR dhe Divizioni Penal për të garantuar efikasitet në këtë Departament.

Rekomandimet për këtë vit:

- a) Të eliminohen shtyrjet e panevojshme;
- b) Të përfundohen të gjitha lëndët që janë në kompetencë të Departamentit për të Mitur;
- c) Shkalla e spastrimit të lëndëve në vazhdimësi duhet të jetë mbi 100% minimalishtë;
- d) Angazhimi i gjyqtarëve nga Departamentit për Krime të Rënda dhe Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për të Mitur

1.3. Departamenti Përgjithshëm/Divizioni Penal

Përshkrimi:

Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, do të punojnë pesë (5) gjyqtar, të cilët do të mbështeten edhe nga gjyqtarët Hysnije Gashi dhe Faton Ajvazi. Është e rëndësishme që të ketë kontinuitet me vitin 2018, pasi janë përfunduar numër i lart i lëndëve për gjyqtar dhe ky trendë duhet të mbahet dhe të avancohet edhe në të ardhmen.

Megjithatë, tek lëndët që për shkak të natyrës dhe thjeshtësisë konsiderohen të lehta për t'u zgjidhur, duhet të ndërtohen praktika standarde dhe të konsoliduara në mënyrë që të përfundohen

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

më shpejt dhe me angazhime minimaliste, në këto lëndë nuk duhet të tepruhet me shtyrje dhe seanca të panevojshme.

Rekomandimet :

- a) Të aplikohet standardi që lëndët të tre shtresëzohen duke i ndarë: në të thjeshta (të cilat mund të kryhen me angazhim minimal apo modest të gjyqtarit siç mund të jenë urdhrat ndëshkimor, lëndët me pranim të fajësisë, lëndët e vendosura jashtë shqyrtimit gjyqësor);
- b) Lëndët standarde (lëndët tipike që kryhen me angazhimin normal të gjyqtarëve që kërkon mbajtjen e seanceve, dëgjimin e dëshmitarëve, të pandehurit, administrimin e provave) Lëndë të komplikuar (përfshihen lëndët me numër të madh të pandehurve, disa vepra, numër i madh i dëshmitarëve);
- c) Aplikimi i urdhrat ndëshkimor në të gjitha ato lëndë të cilat në bazë të rrethanave të çështjes konkrete janë të përshtatshme për procedim përmes urdhrat ndëshkimor. Njëkohësisht do të kursente kohën, që gjyqtarët të merren me lëndët që vërtetë për nga natyra dhe pesha meritojnë që të trajtohen në procedurë të rregullt;
- d) Planifikimi me i mirë sa i përket caktimit të lëndëve, duke i identifikuar lëndët në të cilat ka gjasa reale apo në bazë të deklarimeve të mëparshme është e pritshme pranimi i fajësisë. Si rezultat i saj caktimi i një numri më të madh të tyre brenda një dite, pasi që kur të pandehurit pranojnë fajësinë mund të përfundohen shpejt. Caktimi i numrit të vogël të këtyre lëndëve mund ta dërgoj gjyqtarin në një ditë të dështuar apo jo produktive si psh: ka caktuar vetëm dy lëndë, dhe njëra është përfunduar, por lënda tjetër nuk është mbajtur shqyrtimi gjyqësor, ngase nuk është paraqitur i pandehuri, ashtu gjyqtari ka arritur të kryej vetëm një lëndë brenda një dite, edhe pse po të menaxhonte më mire supozojmë se ka caktuar më shumë lëndë dhe të pandehurit kanë pranuar fajësinë do të arrinte të përfundonte më tepër lëndë;
- e) Të bëhen përpjekje që lëndët të përfundohen brenda një seance dhe kjo të jetë një rregull, ndërsa shtyrjet të jenë një përjashtim dhe të bëhen vetëm mbi bazat e propozimeve të justifikueshme të cilat thelbësisht i kontribuojnë çështjes, dhe jo të aprovohen propozimet nga palët pa një vlerësim dhe vështrim kritikë. Në këtë mënyrë pretendohet të eliminohet kultura e shtyrjeve të panevojshme;
- f) Politika ndëshkimore duhet të rishikohet veçanërisht tek disa vepra të cilat për nga natyra dhe shtrirja e tyre meritojnë që kryesve të tyre të ju shqiptohen dënime më të ashpra. Këto vepra mund të jenë si p.sh: vjedhjet e rënda, mashtrimi, lëndimi i rëndë trupor, e në veçanti kujdes

duhet ti kushtohet kryesve të veprave penale vjedhja e pyllit, tek të cilat na paraqiten kryesisht personat recidivistë, ndaj tyre duhet të kihet parasysh kjo rrethanë me rastin e matjes së dënimit, ngase është jashtë çdo logjike juridike që një recidivisti ti shqiptohet dënim i kushtëzuar. Gjithashtu kur kihet parasysh se kjo vepër ka shënuar rritje dhe se pyjet si pasuri kombëtare me rendësi jetike për biodiversitetin e natyrës dhe kualitetin e jetës të gjeneratave të tashme dhe të ardhshme po dëmtohen në masë të madhe dhe përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe për të parandaluar këtë dëmtim kanë pikërisht gjykatat, si një nga segmentet kryesor të sistemit të drejtësisë penale;

- g) Rekomandohet që prokuroria në çdo rast kur kemi të bëjmë recidivistë të paraqesin dëshmitë e nevojshme se kemi të bëjmë kryes të përsëritur, në mënyrë që të merret parash kjo rrethanë gjatë matjes së dënimit;
- h) Divizioni Penal gjatë vitit 2019 duhet të referojë sa më shumë raste në procedurën alternative - ndërmjetësimin, gjyqtarët do të kenë mbështetje të organizuar nga stafi mbështetës i gjykatës me qëllim të procedimit të sa më shumë lëndëve.
- i) Rrjedhimisht, numri i përgjithshëm i lëndëve që mund të përfundohen brenda një muaji kalendarik nga gjyqtarët e këtij departamenti, duhet të jetë i lartë, pasi kjo mund të arrihet me angazhim dhe përpjekje normale, me një qasje praktike e kombinuar me shkathësi mesatare menaxheriale, njëkohësisht pa e dëmtuar kualitetin e vendimeve dhe procesit në përgjithësi.
- j) Përfundimisht, vetëm kryerja e numri të lëndëve që është dukshëm më e lart se numri i lëndëve të pranuar, mund ta mbajë nivelin e efikasitetit në normat e një performanc të suksesshme.

1.4. Divizioni Civil

Procedura civile duhet të thjeshtësohet, të bëhet më fleksibile dhe më e shpejtë, derisa në të njëjtën kohë të mbahen garancionet e ofruara për palët, përmes rregullave dhe procedurave ligjore. Në mënyrë që të arrihen këto synime, është e nevojshme që palëve t'u vihen në dispozicion forma më të thjeshtësuara, dhe më të shpejta të procedimeve duke i mbrojtur nga vonesa të paarsyeshme, në këtë kontekst veçanërisht është e rëndësishme që gjyqtarët duhet drejtuar seancat në mënyrë më efektive.

Normalisht seancat duhet të përmbajnë jo më shumë se dy seanca dëgjimore, e para nga të cilat mund të jetë seancë paraprake e natyrës përgatitore dhe e dyta për marrjen e provave, dëgjimin e

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

argumenteve dhe nëse është e mundur marrjen e vendimit.¹ Gjykata duhet të sigurohet se janë marrë të gjithë hapat e nevojshëm për dëgjimin e dytë dhe që janë brenda afatit, dhe në parim, nuk duhet të lejohet asnjë shtyrje, përpos kur paraqiten fakte të reja apo në rast të rrethanave të tjera përjashtuese apo të rëndësishme. Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjatë vitit 2019 do të punojnë dhjetë (10) gjyqtar, njëri prej tyre në lëndët përmbartimore.

Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet strukturës së lëndëve të kryera, në mënyrë që mos të dominojnë lëndët e natyrës së lehtë, të zgjidhen lëndët që kanë konteste reale sidomos atyre që kanë të bëjnë me pronësinë dhe raportet mes palëve kontestuese të cilat janë të acaruar, përkatësisht kontestet reale, në të cilën qytetarët kanë problemet më të mëdha dhe për kohë të gjatë presin dorën e drejtësisë.

Gjyqtarët e këtij divizioni duhet të jenë të zellshëm, të tregojnë angazhim të lartë dhe t'i kushtojnë më shumë vëmendje zgjidhjeve të kontesteve më të komplikuar, në mënyrë që raportet e tyre statistikore mujore të jenë më përmbajtësore, dhe jo numra të cilat në esencë mund të pasqyrojnë më tepër fiktivitetin e një norme orientuese se sa të një norme reale.

Rekomandimet :

- a) Aplikimi i dispozitave ligjore të cilat racionalizojnë procedurën siç janë: marrëveshjet gjyqësore, aktgjykimet për shkak të pohimit, për shkak të mos bindjes, për shkak të mungesës, aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes po që se i padituri në përgjigje në padi ka pohuar faktet vendimtare përkundër kontestimit të kërkesëpadsisë e cila autorizon gjykatën që të jap aktgjykimin pa caktuar seancë gjyqësore nëse nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e tij - neni 152 i LPK-së;
- b) Të vendoset standard që të gjitha ato lëndë përshirë edhe ato të cilat sapo janë regjistruar të vlerësohet përshtatshmëria për ndërmjetësim, dhe nëse vlerësohen se i plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë të referohen në këtë procedurë pa vonesa;
- c) Paditë të pranuar pa vonesa të i'u dërgohen të paditurve për përgjigje në padi, në këtë drejtim të angazhohen bashkëpunëtorët profesional për të asistuar gjyqtarët;
- d) Vendosja e shpejt dhe brenda standardeve ligjore të lëndëve që janë kthyer në rivendosje nga Gjykata e Apelit dhe eventualisht nga Gjykata Supreme;

¹ Rekomandimi Nr. R (84) 5 nga Këshilli i Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Parimet e Procedurës Civile të Dizajnuar për Përmirësimin e Funksionimit të Drejtësisë (Miratuar nga Këshilli i Ministrave më 28 Shkurt 1984 në takimin e 367 të Zëvendës Ministrave.

- e) Seancat duhet të përmbajnë jo më shumë se dy dëgjime, e para nga të cilat mund të jetë seancë paraprake e natyrës përgatitore dhe e dyta për marrjen e provave, dëgjimin e argumenteve dhe nëse është e mundur marrjen e vendimit. Gjykata duhet të siguroj se janë marrë të gjitha hapat e nevojshëm për dëgjimin e dytë dhe që janë brenda afatit, dhe në parim nuk duhet të lejohet asnjë shtyrje, përpos kur paraqiten fakte të reja apo në rast të rrethanave të tjera përjashtuese apo të rëndësishme;
- f) Të vendosen sanksione kur njëra palë e cila është njoftuar për hapin e mëtejshëm nuk ndërmerr hapin procedural brenda afateve kohore të caktuara nga ligji apo gjykata. Gjykata duhet të jetë në gjendje që të zbatoj sanksione të përshtatshme në rast të mospjesëmarrjes së paarsyetuar të dëshmitarëve. Në rast se eksperti i emëruar nga gjykata dështon të paraqes raportin e tij apo raporti është i vonuar pa arsyetim të mirë, atëherë duhet të zbatohen sanksione të përshtatshme;
- g) Gjykata gjatë seancës përgatitore, por nëse është e mundur gjatë gjithë seancave të luaj një rol aktiv për të siguruar progres të shpejt të seancave dhe që ndërkohë respekton të drejtat e palëve. Në veçanti duhet të ketë autoritet për të urdhëruar palët që të ofrojnë sqarimet e nevojshme, të përjashtohen dëshmitarët dëshmia e të cilëve do të ishte e parëndësishme për lëndën në fjalë, për të kufizuar numrin e dëshmitarëve për një fakt të caktuar kur një numër i tillë do të ishte i tepruar;
- h) Në lëndët përmbartimore, të ndërmerren veprime të menjëhershme për përfundimin e lëndëve të vjetra, kthimi i punëtorëve në punë, ekzekutimet me vlera të larta si dhe të standardizohet ekzekutimi përmes rrugëve bankare si mënyrë më e përshtatshme, më e sigurt dhe e cila do të sjellë më shumë rezultate.

1.5. Divizioni për Kundërvajtje

Përshkrimi

Në këtë divizion punojnë tre (3) gjyqtar, të cilët bazuar në statistikat e gjykatës janë të mjaftueshëm që të ballafaqohen me numrin e lëndëve të pranuar në gjykatë, sidomos kur merret në konsideratë fakti se lëndë të kundërvajtjeve të pranuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Ri për Kundërvajtje është dukshëm më i ulët, në krahasim me vitet paraprake.

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

Me Ligjin e Ri për Kundërvajtje, përkatësisht me zgjidhjen që i përket kompetencës për të vendosur në procedurën kundërvajtëse, shumë kundërvajtje kanë kaluar në juridiksionin e organit kundërvajtës, rrjedhimisht kundërvajtjet që bien në kompetencë e gjykatës janë numër i vogël.

Rekomandimet:

- a) Të përfundohet numër sa më i lartë i lëndëve, në mënyrë që të krijohet kultura e respektimit të ligjit dhe të pengohet maksimalisht parashkrimi i lëndëve;
- b) Rëndësi prioritare zgjidhjes së lëndëve pa vonesa që vijnë nga inspektoratet e ndryshme si ato të ministrive, komunave apo agjensioneve të pavarura për shkak të natyrës dhe ndjeshmërisë;
- c) Rishikimi i politikës ndëshkimore që dënimet të jenë proporcionale duke pasur në konsideratë në veçanti preventivën gjenerale.

II. Komunikimi me Institucione veprimtaria e të cilave ka ndikim në veprimtarinë e gjykatës

Gjykata do të mbaj komunikim mbi baza të rregullta dhe të vazhdueshme me institucionet veprimtaria e të cilave ndikon në punën e gjykatës në mënyrë që tek këto institucione veprimtaria e gjykatave të jetë në agjendat prioritare të tyre.

Bashkëpunimi me policinë sidomos në çështjet e ekzekutimit të urdhëresave, do të monitorohet mbi baza mujore dhe do të këtë takime të rregullta me drejtues të policisë përkitazi me ecurinë e zbatimit të urdhëresave. Gjithashtu me njësinë për sjelljen e personave të paraburgosur do të këtë koordinim të duhur në mënyrë që mos të këtë dështim apo vonesa të seancave të caktuara.

Planifikohen takime edhe me drejtues të institucioneve tjera si Shërbimi Sprovues, Postë Telekomi i Kosovës etj, në funksion të ngritjes së efikasitet të punës së Gjykatës dhe evitimit të pengesave të mundshme.

Bashkëpunimi me programin e CEPEJ të Këshillit të Evropës dhe ekspertët e këtij organizmi në shkëmbimin e eksperiencave ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe kohore, si dhe implementimin e udhëzimeve të SATURN për menaxhimin e kohës së gjykimit të çështjeve. mbledhjen e të

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

dhënave të sakta dhe të besueshme statistikore dhe aspekte të tjera të rëndësishme për cilësinë e shërbimeve gjyqësore.

Përfundimi

Si përfundim presim që viti 2019, të jetë vit i suksesshëm si në aspektin e përfundimit të lëndëve, efikasitetit të gjyqtarëve, por edhe administratës në përgjithësi. Vonesat në trajtimin e lëndëve duhet ti takojnë të kaluarës, aplikimi i zgjidhjeve alternative të lëndëve si penale ashtu edhe ato civile - ndërmjetësimi, marrëveshja për pranimin e fajësisë, urdhrat ndëshkimor, racionalizimin e seancave tek rastet jo të komplikuar, është e nevojshme që të avancohen në praktika përditshmërie të zgjidhjes së çështjeve gjyqësore.

Vëmendje e posaçme do të i kushtohet lëndëve që janë në rigjykim dhe rivendosje, pasi pikërisht te këto lëndë ekzistojnë vonesa, që duhet sa më parë të eliminohen dhe çështjeve të i'u hapet rruga drejtë epilogut përfundimtar. Është synuar që gjykata të jetë aktive në procedimin e çështjeve duke e minimizuar kohën pasive të lëndës, ashtu që edhe këtë vit do të angazhohemi në kontrollin paraprak të padive në kohën sa më të shkurtë, në mënyrë që të identifikohen lëndët të cilat mund të përfundohen në këtë fazë apo edhe të eliminimit të mangësive në periudhën sa më të hershme të procedimit të tyre.

Ky plan dhe program mund të ndryshohet dhe plotësohet nga kryetari i gjykatës varësisht nga nevojat për organizimin më efektiv të punëve, zgjidhjen më efikase të lëndëve dhe në rast të ndryshimit të numrit të gjyqtarëve dhe strukturës së gjykatës.

Ky plan i punës dhe programi për zgjidhjen efikase të lëndëve, zbatohet nga 1 janar 2019.

Bashkim HYSENI

Datë: 31 dhjetor 2018

Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj

Plani dhe Programi Vjetor i Punës 2019

Me këtë plan do të njoftohen:

Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
Gjykata Supreme e Kosovës dhe
Gjykata e Apelit e Kosovës.